



91- Prot. IZLAZNI DALËSE
Nr. lot. 01-020108-5406/22
Br.str.
Nr.fq.
Datum 28.04.2022
Data



Republika Kosova-Republika e Kosovës Republic of Kosovo

Opština Štrpce

Komuna e Shterpçës

Municipality of Strpce

Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shterpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shterpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 27/04/2022 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 25.02.2022

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit te Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS	
OPSTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS	
01	Prot.
Mr. / M.	01-020108-5406/22
Br.str.	
Nr.i fq.	
Datum	28.04.2022.
Data	
ŠTRPCE - SHTËRPCË	



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republik of Kosovo

Skupstina opštine štrpcce

Kuvendi i Komunës së Shtërpçës

Municipality of Strpce

PROCESVERBAL

Nga seanca e parë e rregullt e KK-ës të mbajtur më 25.02.2022, me fillim në ora 10:00 h.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2021
4. Prezantimi i raportit finansiar për periudhën Janar - Dhjetor 2021
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2022
6. Formimi i Komitetit Komunal për Siguri në Bashkësi
7. Raporti i Kryetarit të Kuvendit për realizimin e Planit të Punës për vitin 2021
8. Të ndryshme.

Seanca e parë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Shtërpçës ka filluar punën, kur Kryesuesi i Kuvendit z. Predrag Grbic ka konstatuar se në seancë kanë qenë të pranishëm 14 nga gjithsej 15 këshilltarë dhe me këtë ka theksuar se ka kuorum për fillimin e seancës. Kuvendi filloi me pikën e parë të rendit të ditës, ku me atë rast këshilltari z. Sllavisa Vasiljevic, ka propozuar që në seancë të shtohen edhe dy pika të rendit të ditës. E para ka të bëjë me Qendrën e Skijimit në Brezovicë dhe me atë rast ka theksuar se sezoni turistik ka filluar një muaj më vonë se sa ishte paralajmëruar dhe se është emëruar Bordi i ri Drejtues në bashkëpunim me Agjencinë e

Privatizimit dhe se pas kësaj Qendra e Skijimit ka hyrë për herë të parë në sistemin fiskal dhe finansiar të Kosovës. Ai gjithashtu mendon se një vendim të tillë nuk është dashur ta marrë vetë kryetari i komunës, por është dashur të diskutohet në Kuvend. Propozimi i dytë lidhej me ndalimin e përhershëm të ndërtimit të mini hidrocentraleve. Ka cekur se janë ndërtuar dy mini hidrocentrale, një në dy lumenj edhe në Parkun Kombëtar dhe kjo ka shkaktuar trazira të qytetarët ku edhe njësitetë speciale të policisë kanë përdorur forcë ndaj qytetarëve, protestues. Ai po ashtu tha se Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë vendim për pezullimin e punimeve në mini hidrocentrale dhe se procesi është udhëhequr nga disa OJQ para gjykatës dhe se është e rëndësishme që komuna të respektojë vendimin të cilat janë në interes të qytetarëve të Shtërpçës.

Kryetari i komunës z. Dalibor Jevtic, i cili me atë rast theksoi se nuk do të thotë se nëse dikush e ka bërë kasat fiskale, që dikujt keni dorëzuar diçka, gjithashtu tha se e dinte që z. Slavisa Vasiljevic është pajtuar që udhëheqësi e INEX-it të arrestohen, për të përfituar politikisht, por kjo nuk do të ndodhë derisa ai është kryetari i komunës. Ai deklroi një qëndrim të qartë se si kryetar i komunës do të luftojë që qendra e skijimit të kalojë nën menaxhimin e plotë të komunës së Shtërpçës. Ai po ashtu theksoi se falë kryetarit të mëparshëm, Bratislav Nikolic, e gjithë toka e Qendrës së Skijimit është në pronësi të komunës së Shtërpçës dhe se është penguar çdo privatizimi. Me futjen e kasave fiskale është futur një rendi fiskal, ku ne si vetëqeverisje lokale do të rrisim hyra vetanake. Ai gjithashtu tha se do të jetë me punëtorët e Qendrës së Skijimit, i ka thënë se cilat janë opzionet dhe se ata vetë do të vendosin si kolektiv për hapat e mëtejshëm. Sa i përket hidrocentralit, kryetari ka pyetur se ku dhe çfarë po ndërtohet, çfarë është ndërtuar, është ndërtuar dhe kjo është në procedurë. Aktualisht jemi në procesin e ndryshimit të Rregullores për Tatim, ku mund të fitojmë edhe më shumë, ku do të mbledhim taksa nga kompania që prodhon energjinë elektrike. Dhe lidhur me leje që kanë të bëjnë me punën e vetë hidrocentralit, Ministria e Planifikimit Hapësinor është ajo që i ka dhënë lejet dhe komunës nuk ka drejt me dhënë. Propozimi i kryetarit të komunës për këshilltarët ishte që të refuzohet përfshirja e këtyre dy pikave në rendin e ditës së sotme.

Pastaj Slavises Vasiljevic është lajmëruar për fjalë por kryesuesi i ka shpjeguar se sipas rregullores nuk ka të drejtë të flasë dhe se propozimet e tij mund të diskutohen nëse janë në rend dite. Më pas është votuar për propozime të paraqitura nga z. Vasiljevic dhe ai nuk ka marr mbështetje nga këshilltarët, të cilët votuan kundër këtyre dy propozimeve me 14 vota "kundër" dhe 1 "për Pas kësaj është qit në votim rendi i ditës i parashikuar për këtë seancë dhe me atë rast 14 këshilltarë votuan "prér" dhe 1 "kundër".

Më pas kaluam në pikën tjeter të rendit të ditës, që ishte miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar, pasi nuk u lajmëruar askush, kryesuesi e vuri në votim këtë pikë, ku është konstatuar se është aprovuar më një zërë .

Pika e radhës e rendit të ditës ishte raporti për punën e kryetarit të komunës për vitin paraprak. Fjalën e mori z. Jeftic dhe më këtë rast fillimisht iu referua faktit se është krenar për atë që ka bërë Bratislav Nikolic, jo vetëm vitin e kaluar, por edhe në 3 mandatet e mëparshme. Ai theksoi

se Shterpce tani është një vend shumë më i mirë se sa ishte shumë më herët, por edhe se ka ende probleme dhe sfida me të cilat duhet të përballemi. Ai gjithashtu theksoi se pandemia e coronavirusit ka ndikuar në punën e vetëqeverisjes lokale, si dhe në zgjedhjet lokale dhe se e gjithë kjo është reflektuar në buxhetin e komunës. Ai po ashtu theksoi se do të punohet në përmirësimin e të gjitha shërbimeve që ju ofrohen qytetarëve dhe se projektet të cilat janë të rëndësishme për komunën do të realizohen në këtë vite dhe në vitet në vijim. Nuk ishte i kënaqur me grumbullimin e të hyrave vetanake, që nuk ka qenë të keq, por duhet të përpinqemi t'i përmirësojmë, sepse ne si komunë jemi shumë të varur nga të hyrat vetanake. Ajo që përmendi është fakti se ne jemi shembull i multietnicitetit në Kosovë dhe se si është e mundur që komunitetet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin pa asnje problem, sepse paqja dhe stabiliteti nuk kanë alternativë, kështu që vetëm në atë mënyrë mund të tërheqim investime. Ai theksoi rëndësinë e projekteve të detajuara që varen nga niveli qendror, pa të cilat është e pamundur të zhvillohet infrastruktura apo ekonomia dhe ne nuk arrijmë ta përfundojmë këtë proces sepse ka një Bord në nivelin qendror që duhet vetëm të përgjigjet nëse procedura është në përputhje me ligjin dhe kjo gjë e vogël teknike na kushton si komunë. Kryetari e përfundoi prezantimin e raportit duke vlerësuar punën e atyre që kanë punuar në periudhën paraprake, duke marrë të gjitha faktet që kanë ndikuar negativisht në punën e komunës dhe se kemi një detyrë përparrë nesh, ku do të përpinqemi të përbushim më mirë kërkuesat e qytetarëve tanë.

Në ndërkohë, këshilltari z. Speitim Arifi, arriti kështu që tani në seancë janë të pranishëm 15 këshilltarët.

Për fjalën është lajmëruar z. Vasiljevic, i cili kishte kundërshtime se raporti nuk ishte nënshkruar nga nënkyetari i komunës, por nga z. Jevtic, duke pasur parasysh se z. Jeftic ka qenë në postin e kryetarit të komunës për një periudhë të shkurtër kohore, po ashtu ka menduar se nënkyetari është dashur ta prezanton raportin për këtë arsyë g. Vasiljevic beson se prezantimi i kryetarit dhe përbajtja e marrë në material janë në kundërshtim të plotë. Ai u ankua se pjesa hyrëse ishte e shkurtër dhe raportet e Drejtive janë pak më të zgjeruara dhe mendon se është dashur të jetë e kundërtë dhe tha se kjo flet si ka qenë puna e kryetarit të komunës në periudhën paraprake. Ai u interesua se kush e ka nënshkruar për Drejtoren për Zhvillim Ekonomik dhe Urbanizëm, sepse raporti është raporti i drejtive, ato e ka pyetur për shkak se ata drejtor janë burgosur. Ai kishte një ankesë për Drejtoren e Shëndetësisë, për shkak se raporti nuk ishte i plotë të shëndetësia primare, në pjesën serbe ku ofrohen shërbime shëndetësore, për dallim nga Drakoc dhe Brod ku ekziston. Ai po ashtu tha se nuk kemi raport për punën e shëndetësi sekondar, gjegjësisht spitaleve, pasi kemi buxhet për pagat dhe mëditje, për mallra dhe shërbime, kështu që sipas tij, ai raport është dashur të jetë më i detajuar. Ai gjithashtu theksoi se në kuadër të shëndetësisë është shëndeti publik, i cili përfshin inspekconin sanitari dhe se duhet të jemi të informuar, p.sh., çfarë lloj uji pimë, sa herë në vit kontrollohet cilësia e ujit dhe më tej ka kritikuar raportin sepse nuk dimë se cilat janë kushtet sanitare dhe higjenike në objektet e hotelerisë. Ai po ashtu theksoi se ka mungesë të informacionit, se si përdoret buxheti për paga, veçanërisht në pjesën serbe të shëndetësisë, sepse e dimë që shërbimet shëndetësore funksionojnë në sistemin e Republikës së Serbisë, dhe

në anën tjetër Drejtoria e Arsimit ka buxhet të planifikuar për anën serbe. Ai po ashtu tha se raporti i Drejtorisë së Arsimit është i shkurtër, nuk kemi të dhëna se sa fëmijë ndjekin shkollën fillore dhe të mesme, sa punëtor të arsimit ka dhe si përdoret buxheti. Ai ishte i mendimit se pyetjeve të tij nuk duhej t'u përgjigjej kryetari i komunës, por këshilltarët, ku në diskutim u bashkua edhe kryesuesi, por u ndërpre nga z. Vasiljevic, i cili u ankua se kryetari i komunës i ndërhyr vazhdimisht, ku kryesuesi e paralajmëroi të mos e ndërpiste dhe se nuk ishte i njoftuar me funksionimin e Kuvendit dhe se kur mund të merrte fjalën, nëse lajmërohet për replikë, mundet me fol 2 minuta. Pas kësaj, kryetari i tha këshilltarit se i ka ngatërruar shumë nga ato që ka thënë, sepse komuna punon sipas sistemit të Kosovës dhe jo sipas sistemit Serbisë. Përsëri, kryesuesi i paralajmëroi Vasiljevicin që të mos e ndërpresë atë sepse po e çonte Kuvendin në drejtimin e gabuar. Më pas foli kryetari i komunës, ku tha se z. Vasiljevic ka ngatërruar të gjitha, duke mos ditur se në cili institucioni është dhe kryetarit dhe theksoi se raporti është nënshkruar nga nënkyetari. Ai gjithashtu theksoi se Vasiljevic tha se arsimi paguan për shëndetësinë dhe se kjo është thënë nga padija e këshilltarit Ai e ka tërhequr vërejtjen se duhet të respektojë punën në Kuvend, ndërsa ka sqaruar se raportin e paraqet kryetari aktual. Ai dha arsyetimin për inspepcionin sanitari si përgjigje në pyetjen dhe tha se qeveria qendrore ka marrë vendim për rajonizimin e inspekçinit sanitari dhe ne nuk kemi më inspektorë sanitari dhe kemi vënë në dukje këtë problem, por nuk kemi marrë asnje përgjigje nga institucionet kompetente. Ai theksoi se po na kritikon ne, në vend të pushtetit qendor, sepse ato gjëra nuk kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale. Ai përmendi se Qeveria e ka marrë këtë vendim për inspektorët sanitari dhe se të gjithë u habitën nga kjo, dhe u bë pyetje se kush do të jetë përgjegjës për helmimin nga ushqimi, le të themi, dhe se këto janë fakte dhe këtë duhet ta dinë qytetarët. Sa i përket raportit dhe pyetjes se kush e ka bërë raportimin në Drejtorit ku nuk ka drejtorë, z. Jevtic u përgjigj se ka zyrtarë dhe zëvendësit e tyre që e bëjnë këtë për ta. Dhe posaçërisht ka theksuar duke e drejtuar tek këshilltarin z. Vasiljevic, se sa herë që flet për ish-kryetarin z. Bratislav Nikolic, duhet të flas me respekt, për arsyen se ka bërë shumë për familjen e tij. Për shkak të ndërhyrjes së vazhdueshme në fjalën e kryetarit të komunës nga ana e z. Vasiljevic ai ju ka drejtuar edhe kryesuesi z. Grbic, duke thënë se e di që është tolerant, por rendi duhet të respektohet dhe se rregullorja e punës është e qartë, ku ka thënë se e ka shkelur gjashtë herë rregulloren dhe se z. Grbic nuk e ka paralajmëruarasnëherë këshilltarin dhe ka kërkuar që të respektohet plotësisht rregullorja e punës dhe të gjitha gjenjeshrat dhe të pavërtetat të marrin përgjigje adekuate dhe këtu nuk ka vend për manipulime, por vetëm e vërteta. Fjalën e mori edhe këshilltarin z. Miroslav Djordjevic, i cili është ndërlidhur më fjalimin e kryetarit, duke thënë se të gjithë duhet ta themi emrin e z. Bratislav Nikolic, me respekt, tha se raporti mund të jetë i shkurtër, por shikoni përreth dhe do të shihni se veprat e tij janë gjithandjej rreth nesh dhe se drejtësia do të dalë në fushë, herët apo vonë. G. Vasiljevic mori fjalën dhe tha se raportin e ka nënshkruar kryetari e jo nënkyetari, siç thotë ai, dhe ka menduar se raportin e drejtorive duhet ta dorëzojnë të gjithë drejtorët, sepse kështu na është munguar prezantimi i raportit. Ai gjithashtu tha se nuk ishte përfaqësues i urrejtjes dhe se kryetari e provokonte me këmbëngulje dhe se mua dojë të vendosen disa masa disiplinore për t'u larguar nga seanca. Më pas kryesuesi ju ka drejtua z. Vasiljevic, dhe i

kishte thënë se e kishte ndërprerë kryetarin e komunës në raste të panumërtë, ai gjithashtu përmendi se ishte shumë tolerant, por se duhet të respektohen rregullat e punës dhe se ai duhet të flasë vetëm kur të marrë fjalën. Pas kësaj, kryetari i komunës tha z. Vasiljevicit që duhet të mësojë, të studiojë ligjin së kush e dorëzon raportin, drejtorët e drejtorive i raportojnë kryetarit të komunës dhe se drejtorët e drejtorive nuk mund të nënshkruajnë raportet. Kjo pikë u hodh në votim dhe u miratua me 14 vota për dhe 1 kundër. Kaluam në pikën tjetër, që ishte raporti financiar i vitit të kaluar, ku drejtori i financave me atë rast, z. Djorgje Djorgjevic tha se raporti është paraqitur në formë tabelorë dhe se janë paraqitur të gjitha informacionet për buxhetin. Raporti i paraqet gjendjen reale të komunës me të dhëna të detajuara për secilën kategori ekonomike dhe se janë 17 programe buxhetore dhe se jepet informacion për 5 kategori të shpenzimeve, për paga, mallra dhe shërbime, komunale, subvencione, transfere dhe investime kapitale. Ai e përmendi se buxheti fillestar i komunës ka qenë 3,643,263 €, por më vonë është rritur për shkak të shumës së mbetur nga DEMOS në vlerë prej 7,518€ dhe në gjysmën e parë të vitit ka pasur rritje të buxhetit fillestar dhe të hyrave vetanake të pashpenzuara, ka pasur edhe donacione nga DEMOS-i, kështu që duke marrë parasysh buxhetin për vitin 2021 ka qenë 3.771629.96. Ai më pas tha se të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2021 kanë qenë 414,299 €, ose 95.05% e tyre janë realizuar. G. Vasiljevic mori fjalën dhe fillimisht u ankua se i mungonte një pjesë e raportit që kishte marrë në material, duke besuar se ishte ose një gabim i administratës ose se ishte bërë qëllimi. Ai më tej ka thënë se është bërë në formë sintetike, gjegjësisht se është i paplotë, nuk kemi pasur detaje se si janë shpenzuar paratë, po ashtu ka menduar se ka pasur qëllim që të fshihet nga qytetarët se si është shpenzuar buxheti i komunës jonë, se komuna shpenzon 34,000 € për dreka zyrtare, shpenzon mbi 6,000 € në vit për udhëtime pune, shpenzon 17,000 € për telefonë mobile, për mbushje telefonave mobile, dhe se ky informacion nuk është në raport. Ai beson se para votimit duhet të marrim një raport të detajuar dhe se nuk mund ta miratojmë kështu si është. Kryesuesi e paralajmëroi që të mos e votojë këtë raport. Më pas kryetari i komunës ju ka drejtua këshilltarit duke i thënë se kjo tashmë po bëhet qesharake, që ai nuk di shumë për këtë, por se është i ri dhe ka kohë të mësojë ligjin. Vasiljevic mendon se duhet të merrte fjalën drejtori, ku rezulton se në këtë seancë duhet të flasin vetëm ai dhe kryetari i komunës, i cili i provokon gjatë gjithë kohës. Unë jam duke udhëhequr kuvenden, tha kryesuesi, dhe ai nuk mund të detyrojë askënd të flasë. Kryetari i komunës ju ka drejtua, dhe ka thënë se nuk e kishte të qartë se si dikush nga injoranca e tij po përpinqej me këmbëngulje të dëshmonte të njëjtën gjë, se nuk mund të përcaktonte se kush do të fliste në Kuvend, duke ju drejtar z. Vasiljevicit, se mund ta bëjë këtë në profilet e tij në FB. Më pas ai tha se do t'i njohë të gjithë me aktivitetet e këshilltarit z. Vasiljevic dhe se do ta bëjë në një nga seancat dhe qytetarët do ta shohin se për çfarë po flet. Më pas ai e pyeti Vasiljevicin se pse nuk e shqetëson përgjigjen që i jep drejtori i ri dhe jo paraardhësi i tij. Ai më pas tha se duhet të flasë për të mohuar gjenjeshtrat, sepse ato e destabilizojnë situatën në komunën tonë dhe se ai si kryetar dëshiron një situatë të qëndrueshme, të cila do të kontribuojë në zhvillimin e komunës së Shtërpcës në drejtim pozitiv dhe theksoi se sa i përket raportit se disa projekte nuk janë realizuar, por jo sepse nuk ka dashur kryesia komunale, por sepse nuk kemi pasur korrespondencë nga niveli

qendror i qeverisjes në përputhje me ligjin, sepse pushteti lokal duhet të punojë në përputhje me këto procedura dhe të mos varen të gjitha nga na. Kjo pikë nuk votohet, kështu që kaluam në pikën tjetër të rendit të ditës, që ishte plani i punës së Kuvendit, ku kryetari shpjegoi gjithçka që lidhet me planin e punës, ku tha se është e pamundur të bëhet një plan perfekt, se ai mund të ndryshohet, por që ky plan është një bazë mbi të cilën duhet të punohet. Për këtë pikë u lajmeruar drejtori i administratës z. Havzi Ahmeti, i cili propozoi që në muaj prill të përfshihet në planin e punës së Kuvendit: shqyrtimi dhe miratimi i mbajtjes së debatit publik për draft planin e Rregullores për Transparencë dhe për muajin qershori shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Transparencë. Ai theksoi se këto propozime kanë ardhur si rezultat i disa ndryshimeve në ligj, andaj duhet të bëjmë disa ndryshime që të janë në përputhje me udhëzimet administrative të MAPL-së. Plani i punës është miratuar me këto dy propozime, me 14 vota për dhe 1 kundër. Pika e radhës është formimi i Komitetit për Siguri në Komunitet dhe kryetari tha se ai është formuar në bazë të udhëzimit administrativ të MPB-së dhe udhëzimit administrativ të MAPL-së, ku shihet qartë se kush mund të jetë përfaqësues i këtij komiteti.

Fjalën e mori z. Vasiljevic tha se këshilltarët është dashur t'i marrin ato udhëzime administrative për t'u njojur me gjithë procedurën, ku po ashtu mendon se anëtarët e zgjedhur janë të përshtatshëm për kryetarin e komunës dhe jo ata që do t'i përfaqësojnë ato institucione. Ai ka marrë për shembull përfaqësuesin e Kishës Ortodokse Serbe, ndaj është interesuar nëse ai është zgjedhur nga Kisha Ortodokse Serbe, apo nga kryetari i komunës, ku ka thënë se e njëjtë gjë është edhe me përfaqësuesin e Bashkësisë Islame. Të njëjtën ka pyetur për përqafuesin e komunitetit Rom. Atij i interesonte edhe fakti që një nga anëtarët ishte edhe drejtori dhe pyeti se kush e ka zgjedhur dhe mbi çfarë baze. Pas fjalimit të këshilltarit, kryesuesi tha se nuk e ka lexuar siç duhet materialin, ku shkruhet qartë se kryetari i komunës e ka dhënë këtë propozim. Kryetari i komunës vazhdoi në këtë temë, ku tha se këshilltar z. Vasiljevic nuk e di se për çfarë bëhet fjalë dhe po të kishte bërë pak përpjekje mund t'i gjente këto udhëzime administrative në internet dhe se gjërat janë shumë të qarta kur bëhet fjalë për propozimin e anëtarëve dhe ato janë në përputhje me të gjitha ligje. Vasiljevic më pas tha se ky komitet është shumë i rëndësishëm dhe se këtu nuk ka asgjë qesharake dhe mendoi se kryetari i komunës po mundohej ta provokonte. Ai po ashtu ka theksuar se kryetari e ka quajtur pjesëtar të shërbimeve të ndryshme, deri ai ka propozuar një pjesëtar para KBC-së, me të cilin beson se vërteton se kush me kë po bashkëpunon. Pas kësaj është lajmëruar kryetari i komunës, ku z. Vasiljevic e ka ndërpre dhe kryesuesi e ka dhënë vërejtje, sepse ai vazhdimisht e ka shkel Rregulloren e Punës. Kjo pikë u miratua me 14 vota për dhe 1 kundër. Pika e radhës ishte: Raporti i kryesuesit për realizimin e planit të punës së Kuvendit dhe i ka njoftuar këshilltarët se Kuvendi ka punuar sipas planit dhe se plani është përmashur plotësisht ku më pas ka lexuar para këshilltarëve dhe i ka njoftuar për të gjitha pikat e rendit të ditës sipas muajve, si janë mbajtur. Meqë askush nuk u lajmëruar për fjalë, kaluam te pika të ndryshme, si pikë e fundit e rendit të ditës. Kryesuesi i ka shpjeguar këshilltarëve se janë të obliguar që formularët t'i dorëzojnë në Agjencinë kundër ryshfetit dhe korruptionit dhe plotësimi bëhet në muajin mars, si dhe dërgimi i tyre në Agjenci dhe se sanksionet janë të rënda në rast se dikush nuk i plotëson ato. Dhe më pas i njoftoi këshilltarët për propozimin e kryetarit për hapjen e adresave

elektronike të të gjithë këshilltarëve që në të ardhmen t'ju dërgojmë materiale në formë elektronike. Më pas këshilltarëve ju ka drejtuar zyrtari për informim z. Lazar Arsic, ku këshilltarëve i ka shpjeguar se si duhet të hapan e-mail dhe se ai është në dispozicion të tyre kur është fjala për këtë. Fjalën e mori Miroslav Djordjevic dhe me atë rast ju ka drejtuar kryetarit të komunës, ku e falënderoi për gjithçka që bën për komunën tonë, ku po ashtu tha se si banor i fshatit Biti janë mirënjohës për përpjekjet e tij, se ka arritur të sigurojë mjete për ndërtimin e sallës së sportit në Biti e Epërme. Ai kishte një pyetje edhe për drejtorin e shërbimeve publike z. Sinisa Buduric, për problemin e lidhur me qentë endacakë. Drejtori u përgjigj se komuna ka nënshkruar kontratë me një kompaninë e Ferizajt në vitin e kaluar dhe se aktivitetet e planifikuara do të jenë në 3 fazë, mars, gusht-shtator dhe e treta në nëntor-dhjetor. Ai tha gjithashtu se është planifikuar kastrimi e qenve endacakë dhe se qentë agresivë do të kenë një trajtim tjetër. Më pas fjalën e mori Albina Hazizi, e cila u ankua për faktin se afati për dorëzimin e materialeve është 7 ditë pune dhe se ka marrë ftesë në Komitet për Komunitete dhe se të gjithë të tjerët kanë marrë ftesa dhe materiale, por jo ajo e ka marrë vesh për Kuvendin dje në takimin e Komitetit për Komunitete dhe ajo mendoi se nuk ishte e drejtë dhe se edhe zarfi ishte i hapur dhe se ekzistonte mundësia reale që ajo të mos merrte pjesë fare në seancën e sotme të Kuvendit. Ajo kërkoi që kësaj t'i kushtohet vëmendje dhe të paralajmërohen përgjegjësit. Me këtë rast është lajmëruar z. Havzi Ahmeti për të sqaruar të gjithë situatën. Ai tha se ka qenë një gabim teknik dhe se ka ndodhur për shkak se materiali i është dërguar në të njëjtën kohë znj. Blerti Hazizi të cila ka të njëtin mbiemër me Albinen. Sa i përket zarfit që është hapur, ai theksoi se nuk është material që cenon privatësinë e dikujt, por është publik, ndaj nuk është kontestuese, vetëm në rastet kur ligji parashikon një situatë tjetër ku edhe Kuvendi është i mbyllur për publikun. Ai tha se ky lloj dokumenti është transparent dhe se është në dispozicion të qytetarëve nëse dëshirojnë ta shohin, si dhe kërkoi falje, se në të ardhmen do të jemi më të kujdeshëm dhe se nuk ka pasur një qëllim të tillë. Kryetari i komunës shtoi se kjo është një konfirmim i asaj që ai ka kërkuar, e kjo është që në të ardhmen materiali t'u dërgohet këshilltarëve në formë elektronike dhe se diçka e tillë nuk do të ndodhë më. Më pas znj. Hazizi shtoi se kur e ka marrë zarfin e hapur nuk e kam marrë seriozisht, problemi ka qenë kur kam parë që mungon materiali dhe na jemi në pozita të tilla që ndikon në vendimet tona. Kryesuesi tha se personat që kryejnë atë pjesë e punës të mundohen që diçka e tillë të mos ndodhë më dhe kërkon falje për këtë. Z. Vasiljevic mori fjalën dhe tha se në seancën e fundit dikush nga këshilltarët i ka lavdëruar si mirëmbajtjen rrugët, ku menjëherë pas kësaj komuna ka hyrë në probleme katastrofike, ku mund ta shohim vetë dhe se kryetari ishte i pakënaqur me punën e shërbimeve të mirëmbajtjes së rrugëve, dhe kompania u dënuar për këtë. Ai theksoi se është mosmirënjohje që të lavdërohet puna e disa shërbimeve pa e bërë punën e tyre ashtu siç duhet. Gjëja e dytë që ai vuri në dukje ishin mbeturinat që shohim nga të gjitha anët, vendgrumbullimi i mbeturinave është rreth nesh dhe me këtë rast e ka thirr shërbimet për pastrimin e rrugëve për rregullimin e tyre. Ai kishte një pyetje edhe për drejtorin e arsimit z. Spasic, ku tha se Natasha Staletovic nga fshati Gotovushë ishte e punësuar në shkollën fillore në Sevac dhe se paga i ishte anuluar muajin e kaluar, pa marrë vendim për pushim nga puna dhe se ka kontratë deri më 31 gusht 2022, dhe ai u interesua se si mund të

kishte ndodhur, pasi ndaj saj nuk u zhvillua asnë procedim disiplinor? Një pyetje tjetër iu dërgua më 24 janar 2022. është shpallur konkursi për profesorë për grupet ekonomike të lëndëve në SHET "Jovan Cvijic" dhe është pranuar Srdjan Mitrovic, është interesuar nëse ai person do të punësohet dhe nëse ai person është nga komuna jonë dhe se a do të përmbushë detyrat e tij të punës? Ai ka kërkuar që të marrë procesverbalin nga Komitet, ku kryesuesi i ka thënë se nuk mund ta marrë. Ai po ashtu ka thënë se është pajtohet me faktin që materiali dërgohet në mënyrë elektronike, por ka thënë se dashuron që materiali t'i dorëzohet me formë shkrimit. Kryesuesi më pas tha se kompanitë ishin gjobitur dhe se ishte e mrekullueshme ajo që kishte bërë kryetari dhe se ishte një procedurë e lavdërueshme dhe jo për sharje dhe për sa i përket mbeturinave tha se një situatë e tillë ishte gjithandej për shkak të borës dhe se sigurisht që do të zgjidhet. Z. Marjan Spasic u përgjigj pyetjes së z. Vasiljevic duke kërkuar që mund të mos jetë avokati i tij, pra të bëjë pyetje të tilla në Kuvend? Kryetari i komunës ju ka drejtua më pas, tha se z. Vasiljevic ka shkruar gjatë seancës në FB dhe se ka shkruar se ne kemi refuzuar të miratojmë vendimin për ndalimin e ndërtimit të hidrocentralit, duke theksuar se këto janë manipulime për të cilat ai kishte folur tashmë dhe se ai nuk e ka nënshkruar peticonin për ndërtimin të mini hidrocentraleve. Ai e ka përsërit se për momentin nuk po ndërtohet asnë hidrocentral dhe se është e mundur të diskutohet për temën e hidrocentraleve tashmë të ndërtuara. Ai foli edhe për Qendrën e Skijimit, duke thënë se Unë do t'i them z. Vasiljevicit që duhet të shkojë të flasë me punëtorët dhe që ata t'i thonë se çfarë mendojnë për të. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve, ai tha se në procesverbal thuhet qartë se çfarë ka thënë, tha se do të ketë një situatë ku moti do të na vëré në pozitë të vështirë, sepse nuk ka pasur pritshmëri të tepruara nga kompania që ka marrë tenderin. gjë që ndodhi, duke theksuar se ndodh edhe në qytete shumë më serioze. Ndër të tjera ai tha se z. Vasiljevic ka shkruar gjithashtu se një autobus i mbushur me fëmijë ka rrëshqitur dhe autobusi ka qenë i zbratë, dhe raporti i policisë në lidhje me këtë ishte se gomat në autobus ishin të këqija dhe ai tha se nuk ishte në interesin e tij që të shkruante por që të përhap gjenjeshtra. Kompanitë janë njoftuar që të përgatitin për pastrim pranveror dhe se do të bëhet pastrimi i rregullt i hapësirave publike. Sa i përket çështjes së arsimit, ai tha se për të ishte qesharake, sepse z. Vasiljevic ka punuar në një komunë tjetër dhe atëherë ishte mirë deri sa ka humbi punën. Pas kësaj, z. Vasiljevic e ndërpren kryetarin e komunës duke i thënë "do ta humbisni", ai e interpretoi këtë si kërcënim dhe i kërkoi që ta shënone në procesverbal. Më tej, kryetari theksoi se qytetarët e kanë zgjedhur, dhe e ka mposhtur në raundin e parë, dhe aj kur nuk do të jetë si unë dhe se nuk mund ta kuptojë këtë, përsëriti se ai ka fituar në zgjedhje dhe se do ta fitojë gjithmonë, kundër ati dhe politikës së e urrejtjes që paraqet ai. Ai gjithashtu tha se nuk ka asgjë kundër një qëndrimi tjetër politik, por se ka problem nëse ai qëndrim ka për qëllim ka destabilizimin dhe urrejtjen në shoqërinë tonë, se kritika nuk është drejtuar ndaj meje, por ndaj fëmijëve që nuk ai donë të kanë kushte më të mira për sport, ai theksoi se do të kritikojë gjithçka sepse nuk e kupton atë gjëzimin e fëmijëve, duke thënë se ka kritikuar edhe pemën e Vtit të Ri. Ai tha se gjithçka flet për të shikuar mënyrën se si e shikon botën. Në fshatin Sushiq është organizuar ndihma humanitare dhe me këtë ka qeshur, tha se kryetari po mundohet të gjejë ndihmë për njerëzit që kanë nevojë përmes njohjeve të ndryshme, sepse buxheti thjesht nuk i lejon që të

ndihmon të gjithëve. Ai ka theksuar se kritikon çdo gjë që është e mirë, sepse është mirë aty ku ka kritikuar edhe Jovan Memedovicin, i cili e ka promovuar komunën tonë ashtu siç meriton të promovohet. Ai po ashtu tha se nuk ka kritikuar faktin që është anuluar konkursi i rregullt, që më pas të pranohet vëllai i tij, të cilin e kemi ndihmuar në mënyra të ndryshme, ku në atë kohë nuk ka folur me atë, duke menduar se e ka shqetësuar, pa marrë parasysh fakti se është vëllai i tij, dhe ka ardhur koha qe te tille te thajnë diçka kundër dikujt. Ai po ashtu theksoi se ata duan të vijnë në pushtet me disa procese dhe se nuk do të kenë sukses sepse populli i zgjedh përfaqësuesit e tij dhe përderisa është kështu komuna do të udhëhiqet nga ata që mund të kontribuojnë shumë për të mirë. Në fund ai ka thënë se do të luftojë për gjithçka që sjell përfitime për qytetarët dhe komunën. Pas fjalës së kryetarit, kryesuesi i njoftoi se Kuvendi i parë i rregullt i Komunës së Shtërpcës ka përfunduar.

Procesmbajtësi

Staja Markovic

Kryesuesi i K.K.

Predrag Grbic
